



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr 020/04-30707 dt. 07-072021

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr.320-19338, të datës 07.04.2017, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në bazë të Thirrjes për Aplikim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë :

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për mikro biznese dhe Start-Up nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për vitin 2021

I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për mikro biznese dhe Start-Up nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për vitin 2021 janë:

1. Shehrije Mustafa, (kryetar),
2. Qendresë Xhema, (anëtarë),
3. Leutrim Elshani, (anëtarë),
4. Afrone Kajtazaj- Sinani, (anëtarë),
5. Jetmira Morina, nga Shoqëria Civile, (anëtarë).

II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për mikro biznese dhe Start-Up nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për vitin 2021, duke u bazuar në Rregulloren 12 Nr.320-19338, të datës 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

- III. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- IV. Komisioni i lartcekur, ka për obligim që të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha kërkesat, në një afat të arsyeshëm, sipas thirrjes Nr.05-400/01-30303, te datës 06.07.2021 dhe në të njëjtën kohë t'i rekomandoj Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, si dhe Zyrën së Kryetarit, me përfituesit potencial.
- V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- DZHE-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.